

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN** - Departamenti për Krime të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues - gjyqtarin Skender Çoçaj, me procesmbajtësen Birsën Kume - sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit M. J. nga Prizreni, për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope e analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 nën paragrafi 1.9 të KP-së, sipas aktakuzës së PTH në Prizren PP.nr.301/16 të datës 27.04.2017, në shqyrtimin gjyqësor, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Mehdi Sefa, të akuzuarit si dhe mbrojtësit të tij av. H. K., me datë 07.07.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

## I akuzuari:

M. J., nga i ati M. dhe e ëma F. e lindur R., i lindur me në Prizren ku edhe tani jeton në Rrugën " " nr. i pamartuar, me profesion automekanik, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## Ë S H T Ë F A J T O R

Se me datë 30.11.2016 rreth orës 18,35 minuta, në shtëpinë familjare në Rr. " " nr. në Prizren, i akuzuari pa autorizim posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes substanca psiko trope të llojit marihuan të cilët janë shpall me ligj si narkotik, në atë mënyrë që pas një bastisje të shtëpisë dhe të aneksit- shupës janë gjetur dy valixhe me substanca psiko tropike të llojit marihuan në një sasi 51 (pesëdhjetë e një) kilogram të paketuara në qese të zeza të najlonit të cilët kanë qenë të fshehur dhe të mbuluar me qebe ndërsa pjesa tjetër ishte paketuar dhe e mbështjellë me shirit ngjitës dhe e vendosur mbi shporet si dhe dy qese të vogla të përgatitur për të shitur me gram dhe dy peshore digjitale.

- Këso dore ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope e analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 nënparagrafi 1.9 të KP-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të lartshënuara dhe neneve 7, 17 par. 1, 41, 42, 43, 45, 46, nenin 273 par.1 – 281 par.1 – 1.9 të KP-së, të akuzuarin e :

## G J Y K O N

Me dënim me gjobë në lartësi prej 2000 (dymijë) euro, të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë apo nuk mundet ta paguaj, dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 euro të gjobës do të caktohet një ditë burgim si dhe,

Dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite e 6 (gjashtë) muaj në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 05.12.2016 deri më datën 07.07.2017.

Në kuptim të nenit 273 par. 5 lidhur me nenin 69 par. 1 të KP konfiskohet substanca narkotike në sasi prej 51 kg, si dhe dy peshore digjitale.

Obligohet i akuzuari që t'i pagojë të gjitha shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 200 (dyqind) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.301/16 të datës 27.04.2017 kundër të akuzuarit kundër të akuzuarit M J nga Prizreni, për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope e analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 nën paragrafi 1.9 të KP-së. Prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësorë nuk e ka kundërshtuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, në fjalën e tij përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës duke shtuar se me vet pranimin e fajësisë si dhe me provat e mbështetura në tërësi është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope e analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 nën paragrafi 1.9 të KP-së. Ka propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor, ndërsa i ka propozuar gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethanat të cilët ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e në veçanti të merr për bazë shkallën e rrezikshmërisë së kësaj vepre penale, ndërsa si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, pendimin e tij për veprën penale të kryet, njëherit si dënim plotësues ka propozuar që të konfiskohet e tërë sasia e narkotikut si dhe dy peshore digjitale.

Mbrojtësi i të akuzuarit M J av. H: K në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar i mbrojturi i tij i gjendur para aktakuzës së prokurorisë i vetëdijshëm për veprimet e ndërmarra duke treguar përgjegjësi qytetare ka vendosur të pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar. Nga rrjedha hetimore e gjithë kësaj çështje penale për gjykatën dhe prokurorinë e ditur mënyra se si është gjendur ky posedim i mjeteve të narkotikut, por se i njëjti në fund vjen në përfundim që të merr përgjegjësinë për këtë vepër penale me shpresë se gjykata me rastin e marrjes së vendimit do ti vlerëson dhe këto rrethana gjithsesi do të aplikon edhe rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit duke pasur parasysh sjelljen e tij që në fillim të këtij hetimi duke pas parasysh se i njëjti së pari herë gjendet i akuzuar dhe në veçanti edhe për këtë vepër penale, moshën e tij të re, gjithsesi edhe pranimin e fajit, duke pasur parasysh se i njëjti është i pa punë dhe nuk realizon të ardhura personale. Ka propozuar gjykatës që pas marrjes së vendimit trupi gjykues të vlerëson mundësinë e ndërprerjes së paraburgimit me qëllim që i njëjti pasi që është i ri ti kryen disa obligime familjare dhe se më pas të kryen obligimin e vet në bazë të aktgjykimit të gjykatës.

I akuzuari në shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar fajësinë për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope e analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 nën paragrafi 1.9 të KP-së , e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës.

Gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

47

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari M. J. me datë 30.11.2016 rreth orës 18,35 minuta, në shtëpinë familjare në Rr. " " nr. në Prizren, i akuzuari pa autorizim posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes substanca psiko trope të llojit marihuan të cilët janë shpall me ligj si narkotik, në atë mënyrë që pas një bastisje të shtëpisë dhe të aneksit- shupës janë gjetur dy valixhe me substanca psiko tropike të llojit marihuan në një sasi 51 (pesëdhjetë e një) kilogram të paketuara në qese të zeza të najlonit të cilët kanë qenë të fshehur dhe të mbuluar me qebe ndërsa pjesa tjetër ishte pakeluar dhe e mbështjellë me shirit ngjitës dhe e vendosur mbi shporet si dhe dy qese të vogla të përgatitur për të shitur me gram dhe dy peshore digjitale.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vetë pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin gjyqësor pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av. H K. vullnetarisht ka pranuar fajësinë, i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit dhe se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë. Pranimi i fajësisë është mbështetur në faktet dhe provat material të rastit konkret të cilat janë paraqitur në aktakuzë dhe nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara nga neni 253 par.1 dhe 2 të KPP-së.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprave penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata mori pranimin e fajësisë, gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, moshën relativisht të re, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, gjendjen e dobët ekonomike, faktin se është hera e parë që i akuzuari ka ra ndesh me ligjin, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 i KP dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari, se ky dënim do ta parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, gjithashtu do të parandalojë edhe personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.


Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 451 dhe 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN,  
P.nr. 43/2017 më datë 07.07.2017**

**Procesmbajtësja**  
Birsen Kume

**Kryetari i trupit gjykues**  
Skender Çoçaj



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.